

PARATHËNIE

Viti 2021 ishte mjaft sfidues për të gjitha sferat e jetës, e në veçanti për fushën e arsimit. Zhvillimi i procesit edukativo–arsimor u përcoll me probleme ndër më të ndryshmet, ndër to edhe fusha e hulumtimeve dhe kërkimeve në edukim, të cilën e mbulon Instituti Pedagogjik i Kosovës.

Duke tejkaluar rrethanat e krijuara, këtë vit hulumtuesit e Institutit arritën të realizojnë projektet e tyre hulumtuese, duke bërë të mundshëm edhe publikimin e tyre në revistën e përhershme të Institutit, në “*Kërkime Pedagogjike*”, e cila është e konceptuar si tribunë e mendimit dhe hulumtimeve në fushën e edukimit.

Lexuesit e fushës së arsimit, por edhe të interesuarit e tjerë, në numrin e sivjetmë të revistës, mund të informohen më tepër për: arsimin parashkollor në Kosovë, format e zhvillimit profesional të mësimdhënësve, kompetencat digjitale të mësimdhënësve, përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në shkollat profesionale, qëndrimet e mësimdhënësve për lidhjen e teorisë me praktikën, sfidat e mësimdhënësve të shkollave profesionale, normën e shqipes së shkruar, rezultatet e PISA-s 2018 etj.

Rezultatet e hulumtimeve do t’u shërbejnë vendimmarrësve dhe mësimdhënësve për të avancuar praktikën e mësimdhënies dhe nxënies.

Çështjet e trajtuara në këtë numër të revistës “*Kërkime Pedagogjike*” do të duhej të merreshin në konsideratë nga institucionet arsimore dhe të gjithë ata që merren me hulumtime dhe trajtesa të kësaj natyre, si referencë për hulumtime të ngjashme.

Nezir Çoçaj, drejtor i IPK-së